



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu
Nr./Br. 04-614/23-**958/1**

shpallur me: 07.02.2023.

pepunduesht me: 09.03.2023.

Rruga Tuz nr. 1, nr. 44
Ulica Tuzi br.1, br. 44

+382 20 875 167

veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 07.02.2023. godine



Në bazë të nenit 116 paragrafi 4 dhe neni 117 paragrafi 1 i Ligjit mbi sportin (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 44/18, 123/21) e në lidhje me nenin 7 të Vendimit mbi financimin e sportit, (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi” – dispozitat komunale”, nr. 032/19, 019/21), Sekretariati për vetëqeverisje lokale të Komunës së Tuzit shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për bashkëfinancimin e programeve të punës së organizatave sportive për vitin 2023

Lënda e Konkursit është shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Tuzit për vitin 2023 për: programe bashke financuese të punës së klubeve sportive, shoqërive sportive-rekreative, shoqëritë sportive shkollore dhe organizatat sportive të personave me aftësi të kufizuara.

Personat juridikë dhe fizik (sipërmarrësit dhe organizatat sportive) të regjistruara në organin kompetent shtetëror në Mal të Zi për kryerjen e aktiviteteve sportive, me selin në Tuz, pas një viti nga data e formimit të organizatës sportive, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs.

Organizata sportive në konkurs paraqet programin për periudhën prej një viti, me vlerësim të shumës së mjeteve i cili është i nevojshëm për realizimin e programit dhe me planin detajor të shpenzimit të mjeteve.

Krahas fletëparaqitjes në konkurs organizata sportive dorëzon:

- Aktvendimin mbi regjistrimin në regjistrin e organizatave sportive, në pajtim me Ligjin mbi sportin të vitit 2018.
- Raporti finaciari mbi shpënzimin e mjeteve të aprovuara nga Buxheti i Komunës, për vitin paraprak;
- Programi i punës për periudhën prej një viti me një vlerësim të shumës së mjeteve të nevojshme për realizimin e programit dhe planin detalor për shpënzimin e mjeteve – me përshkrim të posaçëm për secilën njësi;
- Vërtetim se nuk ka bllokim të llogarisë bankare dhe borxhe tatimore;
- Vërtetimin i Federatës që organizata sportive merr pjesë në sezonin kompetitiv.

Vlerësimi i programit dhe përcaktimi i shumës së fondeve të ndara për organizatën sportive bëhen në bazë të kritereve të mëposhtme:

- Masoviteti;
- Tradita e ekzistimit të klubit;
- Organizimi i garave shtetërore dhe ndërkombetare;
- Pikëzimi (vlerësimi) i sporteve ekipore;

- rangu i garës,
- pikëzimi i numrit të ligave sipas niveleve garuese,
- suksesi i realizuar i senioreve në kampionatin shtetëror,
- suksesi i realizuar i kategorive të reja në kampionatin shtetërorë,
- suksesi i të gjitha kategorive në Kupën e Malit të Zi;
- Pikëzimi i sporteve individuale:
 - suksesi i realizuar në kampionatin shtetëror,
 - suksesi i realizuar në Kupën e Malit të Zi;
- Numri i reprezentuesve në vitin i cili pikëzohet;
- Pikëzimi i suksesit të realizuar të reprezentuesve në kampionatet ndërkombëtare në sportet individuale dhe ekipore;
- Pikëzimi i sporteve olimpike.

Aplikimi për konkurs me të gjitha kushtet e kërkuara paraqitet në arkiven e komunës së Tuzit me titullin "Konkurs Publik për Sport".

Formulari, i cili është pjesë përbërëse e konkursit, mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Komunës së Tuzit: www.tuzi.org.me dhe direkt nga arkivi i Komunës së Tuzit.

Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në gazetën e përditshme "Pobjeda", në faqen e internetit të Komunës së Tuzit dhe tabelën e lajmërimeve. Zarfet me dokumentacionin do të hapen nga Komisioni për vlerësimin e Programit dhe përcaktimit të vlerës së mjeteve të cilat i ndahen organizatës sportive (në tekstin e mëtejme: Komisioni), pasi të ketë mbaruar konkursi. Komisioni nuk do të shqyrtojë aplikimet e dorëzuar pas afatit të paraparë si dhe aplikimet që nuk janë paraqitur në formularin e përcaktuar.

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale